



QENDRA E TRAJNIMIT TË ADMINISTRATËS TATIMORE DHE DOGANORE

STUDIM

RËNDËSIA E KRIJIMIT TË NJË STRATEGJIE E-LEARNING PËR INSTITUCIONET TRAJNUESE

Tabela e Përmbajtjes

| | |
|---|----|
| Hyrje | 3 |
| 1. Çfarë është mësimi elektronik?..... | 3 |
| 2. Si ofrohet dhe mbështetet E-learning?..... | 4 |
| 3. Strategjia dhe Plani i Zbatimit të E-learning..... | 5 |
| 3.1. Faktori Kritik i Suksesit 1 | 6 |
| 3.2. Faktori Kritik i Suksesit 2 | 6 |
| 3.3. Faktori Kritik i Suksesit 3 | 8 |
| 3.4. Faktori Kritik i Suksesit 4 | 9 |
| 3.5 Faktori Kritik i Suksesit 5 | 10 |
| Sfidat, Risqet and Veprimet Lehtësuese | 11 |
| 4. Përfitimet..... | 12 |
| 5. Strategjia për krijimin e një sistemi të plotë online learning. | 13 |
| 6 Kontrolli i sistemeve dhe asetëve. | 14 |
| 6.1 Asetet fizike..... | 14 |
| 6.2 Asetet software..... | 14 |
| 6.3 Burimet njerëzore..... | 14 |
| 6.4 Analiza e nevojave. | 14 |
| 6.5 Komponentët software | 15 |
| 7. Implikimet Financiare | 17 |
| 7.1. Mbulimi i buxhetit/ Të ardhurat. | 17 |
| 7.2. Kostot. | 18 |
| 7.3 Infrastruktura Fizike..... | 18 |
| Aneks I: Shembull i organizimit të sallës së trajnimit online | 19 |
| Aneks II: Mjetet për transmetimin e trajnimeve Online Streaming..... | 20 |
| Bibliografia | 21 |

Hyrje

Mësimi i shekullit 21 kërkon qasje të reja për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit duke lehtësuar të mësuarit në një mjedis të pasur me teknologji, ku pjesëmarrësit dhe trajnerët nuk mësojnë vetëm rreth teknologjisë, por e përdorin atë për të arritur rezultate të mira të të mësuarit dhe mësimdhënies dhe përmirësimin e rezultateve të të nxënësve të pjesëmarrësve.

Pesë faktorë suksesi mund të shërbejnë si bazë për qëllimet, rezultatet, objektivat, detyrat dhe standartet e strategjisë së mësimin elektronik.

1. Vizioni për të mbështetur mësimin elektronik.
2. Financimi dhe investimet për të mbështetur zbatimin e mësimin elektronik.
3. Politikat dhe procedurat që favorizojnë mësimdhënien.
4. Aksesin në burimet e mësimin elektronik dhe mbështetje.
5. Infrastruktura teknologjike për të mbështetur një program E-learning.

1. Çfarë është mësimi elektronik?

E-learning është një term i përdorur për të përfaqësuar përdorimin, aplikimin dhe integrimin e IT në një mjedis arsimor. Teknologjia duhet përdorur në mënyrë që të përmirësohet mësimdhënien. Megjithatë, nëse duhet që e-learning të shkojë përpara, duhet të sigurohet një kohezion më i madh dhe një mbështetje e centralizuar. Fazat për zbatimin e një programi mësimi elektronik mund të jenë:

1.1 Faza I - Analiza e kërkesave

a) Pritshmëritë që një sistem e-learning kërkon:

- Të konfigurohen kërkesat për një sistem të mësimin elektronik.
- Të përcaktohen nevojat për trajnim.

b) Modeli konceptual i mësimin elektronik kërkon:

- Të sigurohen mjete që lehtësojnë procesin e mësimdhënies (p.sh. kompjuterët dhe projektuesit dixhitalë në vendet e punës, një laborator e-learning etj).
- Integrim të operacioneve me tre zonat kryesore shkollore; mësimdhënies dhe të mësimnxënies, hulumtimit dhe informimit.

2. Si ofrohet dhe mbështetet E-learning?

Shumica e institucioneve kanë një njësi qendrore mbështetëse për mësimin elektronik. Sidoqoftë shumë nga shkollat kanë njësi të brendshme mbështetëse si Zhvillimi Akademik, Edukimi i Vazhdueshëm dhe Teknologjia e Zhvillimit të Asistuar, të cilat gjithashtu ofrojnë mbështetje për mësimdhënien dhe mësimin.

Pothuajse të gjitha institucionet e arsimit të lartë në botë i ofrojnë trajnerëve një formë nxitjeje për të transformuar materialet ekzistuese të kurseve në mjediset online dhe për të eksploruar metoda inovative të mësimdhënies.

Grantet mund të jenë një burim i mirë financimi, që nga momenti kur vendoset të krijohen shërbime të tilla elektronike të institucionit. Këto mund të përfshijnë grante inovative (IG), grante për materialet e kursit (CDG) dhe grante për programime dhe udhëzime teknologjike (TIPG).

Objektivat që zakonisht përdoren në këtë fushë si:

1. Përshkrim i hartimit dhe zhvillimit të kurrikules
2. Procesi Menaxhimi të Cilësisë në vend për të siguruar rritjen e të mësuarit.
3. Iniciativa dhe qasje në zhvillimin profesional të stafit.
4. Struktura për mbështetjen teknike dhe të sistemit, udhëzimin dhe punën me standardet e paracaktuara.
5. Struktura për mbështetjen e klientit (duke përfshirë trajnerët, pjesëmarrësit dhe aktorët e tjerë).
6. Rol dhe kontribute të udhëheqjes dhe menaxhimit të ndryshimeve në nivele të ndryshme të institucionit.
7. Disponueshmëria e resurseve, ndarja e burimeve dhe ripërdorimi: Ku, kur dhe si?
8. Informacion mbi përvojat e studentëve dhe trajnerëve dhe nivelet e kënaqësisë gjatë dy viteve të fundit.
9. Të dhëna përkatëse dhe të kohëve të fundit mbi bashkëpunimet ekzistuese, partneritetet dhe historitë e suksesit në dhe mes institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë.
10. Financim
11. Çështje të burimeve njerëzore.

3. Strategjia dhe Plani i Zbatimit të E-learning.

“Përfitimi kryesor i teknologjisë informative është fuqizimi i njerëzve për të bërë atë që duan të bëjnë, i lejon njerëzit të jenë krijues, i lejon njerëzit të jenë produktivë, i lejon njerëzit të mësojnë gjëra që nuk mendonin se mund të mësonin më parë dhe kështu në këtë kuptim çdo gjë ka të bëjë me mundësitë”. Teknologjia po ndryshon më shpejt se çdo faktor tjetër që na prek, ndikon mjedisin dhe institucionet, ndikon jo vetëm atë që mësohet, por edhe si mësohet.

Analiza të ndryshme në këtë fushë tregojnë se prioritetet kryesore që i shërbejnë nevojave të tyre për mësim elektronik përfshijnë:

- Zhvillimin dhe përditësimin e politikave të mësimdhënies dhe mësimi;
- Promovimin dhe shpërblimin e stafit dhe shkollës për përdorimin e duhur dhe demonstrimin e mësimi elektronik;
- Zgjerimin e numrit të kurseve të ofruara për mësimin gjatë gjithë jetës në distancë;
- Ndihmën për vendosjen e IT në mbështetje të mësimdhënies, kërkimit dhe qasjes së tyre;
- Sigurimin e një mbështetjeje më të madhe të dizajnit teknik dhe mësimor për të ndihmuar në hartimin dhe zhvillimin e materialeve të mësimi elektronik dhe të kërkimit.

Inkurajimi i përdorimit të teknologjive të reja për mësimdhënie mbështetet në ekzistencën e një "mjedisi të përshtatshëm" për aftësitë dhe kompetencat e teknologjisë mësimore të zhvillimit, ofruesit të trajnimit dhe për pjesëmarrësit që kanë qasje në përmbajtjen e kurseve në internet. Politikat zhvilluese duhet të heqin barrierat nëpërmjet sigurimit të burimeve adekuatë dhe të përshtatshme, të zhvillojnë një "kulturë të inovacionit" në të gjithë komunitetin e pjesëmarrësve dhe të krijojë një infrastrukturë dinamike dhe të përgjegjshme që parashikon ndryshimin, dhe nuk reagon ndaj tij.

Kjo mund të realizohet përmes një partneriteti krijues me organizata të mësimi elektronik dhe gjetjes së burimeve të reja për të zbatuar një sistem më fleksibël dhe më të barabartë për ofrimin e shërbimeve dhe mbështetjes. Synimet, rezultatet, objektivat, detyrat dhe matjet e planit mund të jenë pjesë e një plani të një strategjie zbatimi disavjeçare.

3.1. FAKTORI KRITIK I SUKSESIT 1:

Vizion dhe shërbime kohezive për të mbështetur e-learning.

E-learning mund të jetë i integruar ose i koordinuar me profesionistë të fushës teknologjike.

Planifikimi i hapave për arritjen e qëllimit:

| Qëllimi | Arritja e dëshiruar | Objektivat | Detyrat | Metodat e vlerësimit |
|--|--|---|--|--|
| Kërkimi, marrja dhe vendosja e burimeve të brendshme për të ndërtuar dhe koordinuar Mbështetje për e-learning. | Përmbushja me sukses e nevojave për mësim elektronik të studentëve duke ofruar mbështetje dhe lehtësira. | Kërkimi dhe përdorimi në mënyrë efektive i aseteve për të ndërtuar një program dhe kërkuar staf për të mbështetur nevojat e mësimit elektronik. | Krijim i një grupi pune. Caktimi i përgjegjësve për implementimin e strategjisë që të hartojnë nevojat. | Përdorimi i anketimit për të përcaktuar efektivitetin/kënaqësinë dhe për të identifikuar nevojat. Anketim i stafit për të përcaktuar nëse ata mundën dhe kanë potencial për tu bërë pjesë e implementimit. Identifikim, kërkesë dhe rritje e përdorimit të burimeve dhe shërbimeve. |

3.2. FAKTORI KRITIK I SUKSESIT 2:

Financimi dhe investimet të mundshme për të mbështetur zbatimin e-learning.

Financimi është një sfidë për mësimin elektronik. Programet e mësimit elektronik mund të zbatohen për të siguruar një avantazh në përmbushjen e nevojave të ndryshme të pjesëmarrësve duke arritur një numër të madh të tyre dhe duke i dhënë mundësinë që të mësojnë të pavarur dhe të konsultojnë leksionet kur i duhen.

Mund të duhet: Një investim shumë i rëndësishëm në mjete dhe burime njerëzore për të zbatuar një program të suksesshëm të mësimit elektronik. Mundësitë për financim të jashtëm ekzistojnë, por shumë prej tyre kërkojnë bashkëpunime shumëdisiplinore dhe donatorë.

Dobësitë kryesore të burimeve të financimit të jashtëm mund të jenë:

- Mungesa e fondeve të vazhdueshme për investime të disponueshme për të financuar kostot e zhvillimit të programeve fillestare dhe kostot e zhvillimit të programeve të avancuara.
- Nëse mund të duhet të vendoset pagesë extra për marrjen e leksioneve elektronike, sepse përgatitja e tyre përveçse përmbajtjes kërkon audio-video, atëherë do të duhet vendimmarrje dhe procedura për madhësinë dhe mundësinë e arkëtimit, si edhe për mundësinë për t'u përdorur për kostot e zhvillimit dhe të shpërndarjes së projekteve të mësimi elektronik.

Përveç mangësive financiare, mund të ekzistojë problemi i burimeve njerëzore në ndërtimin dhe mbajtjen e një laboratorit të kualifikuar IT për shkak të organizimit që mund të ketë një institucion trajnues.

Teksa teknologjia ndryshon me shpejtësi, stafi duhet të ritrajnohet, ruhet, në mënyrë që të ofrojë mbështetje të pandërprerë dhe cilësore.

Në mungesë të një shkalle karriere dhe një sistemi shpërblimi, rekrutimi dhe mbajtja e një grupi pune cilësor mund të mbetet një problem i vazhdueshëm.

FAKTORI KRITIK I SUKSESIT 2:

Financimi dhe investimet e mundshme për të mbështetur zbatimin e mësimi elektronik i përmbledhur sipas qëllimit dhe hapave për arritjen e tij sipas të dhënave në tabelën më poshtë.

| Qëllimi | Arritja e dëshiruar | Objektivat | Detyrat | Metodat e vlerësimit |
|---|--|--|---|--|
| Të mbështetet zhvillimi dhe shpërndarja e një cilësie të lartë të e-mësimi. | Trajnerët të kenë trajnimin dhe burimet e nevojshme për të integruar teknologjinë mësimdhënies dhe të mësuarit. Pjesëmarrësit duhet të gëzojnë lehtësinë dhe cilësinë e mundësive të mësimi të mbështetura nga teknologjia. Stafi duhet të | Identifikimi i granteve, projekteve dhe të ardhurave që krijojnë mundësi partneriteti. Identifikimi i mundësisë për financimin e duhur. | Të gjitha nevojat e kërkuara nga grupi përgjegjës për implementimin e e-learning duhet të listohen dhe të identifikohen burimet e mundshme të financimit. | Sasia e fondeve e përcaktuara, stafi dhe buxhetet e orientuara drejt mbështetjes së kësaj veprimtarie. Numri i detyrave të përfunduara. Numri i bashkëpunimeve të indentifikuar dhe të kerkuar. Sa janë pergjigjur dhe per sa ? Anketimi Numri i |

| | | | | |
|--|---|--|---|---|
| | ketë trajnimin dhe burimet e nevojshme. | | | pjesëmarrësve. Numri i programeve. Sistemet e Vlerësimeve. |
| | | Investimi në stafin e IT duke mbështetur zhvillimin profesional dhe karrierën përparim | Punimi me burimet njerëzore dhe ofrim mundësie zhvillimi në karrierë. | Numri i stafit të mbajtur. Anketa për kënaqësinë e stafit. |

3.3. FAKTORI KRITIK I SUKSESIT 3:

Politikat dhe procedurat që mund të favorizojnë ofrimin e mësimit elektronik për arritjen e qëllimit sipas hapave të kësaj tablele.

| Qëllimi | Arritja e dëshiruar | Objektivat | Detyrat | Matodat e vlerësimit |
|--|--|---|--|---|
| Përkrahja dhe zhvillimi i politikave dhe procedurave të favorshme për të mbështetur dhe shpërndarë mësimin elektronik. | Mbështetja dhe përcaktimi i qartë i politikave dhe procedurave që të ofrohet sistem e-learning cilësor, që është konkurrues dhe i përgjigjet nevojave të përdoruesve të tij. | Kuptim më të mirë të të mësuarit elektronik të ofruar nga institucione të ngjashme, konkurrencte apo bashkëpunuese. | Listim dhe monitorim i politikave dhe procedurave të e-learning. | Vlerësim për gjetjet. |
| | | Zhvillimi dhe mbështetja e politikave dhe procedurave që janë të favorshme për ofrimin e cilësisë. | Zgjidhja e çështjeve të mësimit elektronik nëpërmjet përdorimit të politikave dhe zgjidhjeve procedurale bashkëpunuese | Numri i çështjeve të zgjidhura. Anketa |

3.4. FAKTORI KRITIK I SUKSESIT 4:

Qasja e përfituesve në burimet dhe mbështetjen e E-learning për arritjen e qëllimit sipas hapave në këtë tabelë

| Qëllimi | Arritja e dëshirueshme | Objektivat | Detyrat | Metodat e vlerësimit |
|---|--|--|---|---|
| Sigurimi dhe koordinimi i aksesit të pjesëmarrësve në e-learning. | Pjesëmarrësit që marrin kurse duhet të kenë një qasje të thjeshtë në shërbime dhe burime pa marrë parasysh nëse ata vijnë fizikisht apo mësojnë në distancë. | Një zgjidhje përfundimtare për zhvillimin dhe shpërndarjen e programeve të kurseve për mësim elektronik. | Listimi i shërbimeve e-learning dhe burimeve të ofruara. Zhvillimi dhe zbatimi i programit të orientimit online për pjesëmarrësit në distancë. | Anketë për të vlerësuar kënaqësinë e pjesëmarrësve Përdorim më i mirë i burimeve dedikuar e-learning nëpërmjet sistemit. Numri i përdoruesve. Feedback nga vlerësimet. |
| | | Krijimi i një pikë portali online të prezencës për ofertat e e-mësimet. | Ridizenjimi për faqen e internetit të mësimet elektronik për të punuar drejt një pike të vetme, të bazuar në internet listat e kurseve online | Hulumtimi i perceptimit të përdoruesve për lehtësinë e përdorimit dhe aftësinë për të gjetur burime. Numri i arritjeve |
| | | | Krijimi i një metode për të ndjekur, përditësuar dhe raportuar statistikatat e të mësuarit elektronik dhe Aktivitetet. | Kërkesat plotësohen në mënyrë të kënaqshme. Numri i kurseve të listuara në sistem. Numri i të rinjve të regjistruar |

3.5 FAKTORI KRITIK I SUKSESIT 5:

Infrastruktura teknologjike për të mbështetur themelimin e E-learning

Infrastruktura teknologjike është elementi kryesor për mirëfunksionimin e mësimit online. Në shumë raste, nisur edhe nga mësimdhënia tradicionale, elementët e shumtë teknologjikë mungojnë dhe mund të duhet të bëhet një programim i të gjithë mjeteve dhe elementëve për realizimin dhe implementimin e një Strategjie E-learning.

Anëtarët e stafit mund të kërkojnë më shumë mbështetje teknologjike për ofrimin e kurseve, kryerjen e kërkimeve, përdorimin e medias së pasur dhe lehtësimin e ndërveprimit midis të trajnuarve.

FAKTORI KRITIK I SUKSESIT:

Infrastruktura teknologjike për të mbështetur themelimin e E-learning sipas tabelës më poshtë

| Qëllimi | Rezultati i pritshëm | Objektiva | Detyra | Matje |
|--|---|---|---|--|
| Ofrimi i trajnimit stafit të menaxhimit të kurseve dhe një infrastrukturë teknologjike që suporton aksesin për përdorimin me lehtësi të mjeteve dhe shërbimeve produktive të mundësuar nga E-learning. | Stafi i menaxhimit të kurseve të trajnimit duhet të ketë njohuri informatike dhe infrastrukturën e nevojshme. | Do të ofrohet stafit teknologji që mbështesin dhe zgjerojnë mësimdhënien dhe të mësuarit. | Krijimi i një platforme për trajnimin dhe ofrimin e shërbimeve për stafin. Ofrimi i një sistemi infrastrukturor të kurseve për trajnimin e stafit. | Përcaktimi i nevojave. Vlerësimi i feedback-ut të përdoruesve. Numri i personelit të trajnuar. |

Sfidat, Risqet and Veprimet Lehtësuese

Implementimi i një shërbimi mbështetës të centralizuar të E-learning nuk vjen i pashoqëruar me sfida dhe rreziqe, të cilat zakonisht ndahen në tre kategori: Financiare, Pragmatike dhe Infrastrukturore. Më poshtë tabela që përcakton sfidat dhe risqet të lidhura me masat për adresimin e tyre

Sfidat, Risqet dhe Aksionet/Veprimet Lehtësuese

| | Sfida dhe Risqe | Veprimet Lehtësuese |
|-------------------------|--|--|
| Financiare | Buxhet i kufizuar për financimin e programit E-learning. | Shikimi i mundësisë së aplikimit në organizata të huaja, për të zhvilluar dhe mirëmbajtur sistemin. |
| | Kostot e mirëmbajtjes së pajisjeve dhe zhvillimeve të reja. | Krijimi i një mekanizmi që zëvendëson asetet teknologjike dhe fondet perkatese. |
| Pragmatike | Vështirësitë e vullnetit të pjesëmarrësve/të trajnuarve për të ndjekur programe elektronike dhe tërheqja/largimi i tyre. | Ofrimi i opsioneve teknologjike të të mësuarit për të trajnuarit. Mblidhet feedback mbi shërbimet ekzistuese. Intervista me pjesëmarrësit. |
| | Mungesa e interesit të të trajnuarve në përdorimin e E-learning. | Investimi në komunikim, marrëdhënie me publikun dhe shërbime të marketingut për të promovuar edukimin online. |
| Infrastrukturore | Infrastrukturë e pamjaftueshme teknike. | Vlerësimi dhe suportimi i E-learning si një mision kritik-operacional. |
| | Dështime të pajisjeve. | Duhet të punësohet staf i talentuar. |

4. Përfitimet

Përfitimet për implementimin e këtij plani strategjik të mësimit elektronik janë disa dhe ndikojnë si tek ofruesit e shërbimit, ashtu edhe tek të trajnuarit/pjesëmarrësit virtualë.

Avantazhet e krijimit të një sistemi E-learning

| |
|--|
| a. Ofrimin e edukimit të duhur dhe cilësor për pjesëmarrësit, bazuar në nevojat për trajnime të parapërgatitura. |
| b. Sigurimin e aksesit të pjesëmarrësve në një mjedis të përshtatshëm elektronik të mësimdhënies dhe të të mësuarit. |
| a. Gjenerimin e njohurive përmes aktivitetit kërkimor të duhur dhe shpërndarja e tyre përmes publikimeve, mësimdhënies dhe zhvillimit. |

Përmirësimi i të Mësuarit dhe Arritja e Edukimit

Implementimi i strategjisë së E-Learning mund të rrisë aftësinë për të ofruar programe edukimi teknologjike, të zgjeruara, në salla dhe virtualisht/online, duke ecur në drejtim të lejimit të teknologjisë në përmirësimin e procesit të të mësuarit dhe si përfundim të përmirësimit të cilësisë së edukimit të një punonjësi fiskal.

Kur koordinohet strategjia e edukimit me zgjidhje të ofruara nga teknologjia, të trajnuarit/pjesëmarrësit përfitojnë nga angazhimi i mjediseve të të mësuarit të përshtatura për të përmbushur stilet e tyre të veçanta të të mësuarit.

Programet do të duhet të dizajnohen sipas nevojave dhe interesave të marrësit në vend të planifikimit dhe burimeve të nevojave të ofruesit.

Si një iniciativë për maksimizimin e kapitalit njerëzor, E-learning rrit aksesin në kurse. Njësitë përfituese mund të kenë akses jo vetëm në pikën e centralizuar të E-Learning të mbledhjes së materialeve të publikuara, por edhe në Databazën e mbledhjes së teksteve dhe medias së pasur, materialeve të kurseve dhe objekteve të të mësuarit. Menaxherët/ trajnerët, që paraqesin, aksesojnë, ruajnë dhe shpërndajnë përmbajtje edukuese janë më të përgatitur për të integruar teknologjinë në mësimdhënie dhe të mësuarit. Ata mund të ndërtojnë eksperiencë të të mësuarit angazhuese dhe interaktive bazuar në rastet praktike të punës, duke përdorur multimedien dhe video transmetimi për të plotësuar përmbajtjen sipas tekstit dhe objekteve të të mësuarit. Ata gjithashtu mund të jenë pozicionuar më mirë për të përdorur teknologjinë për nxitjen e veprimtarisë së tyre kërkuese në mjedisin e të mësuarit, që përkthehet në eksperiencë të të mësuarit të nivelit të lartë për të trajnuarit.

5. Strategjia për krijimin e një sistemi të plotë online learning.

Platforma online learning është një platformë relativisht e komplikuar, e kushtueshme dhe e përbërë nga pjesë software dhe hardware të cilat janë të shumëllojshme. Për këtë arsye strategjia e krijimit, implementimit dhe operimit të platformës online learning duhet të garantojë arritjen e objektivit për të përmirësuar cilësinë e trajnimeve, si dhe për të ofruar mjete moderne të mësimit online duke përdorur teknologjinë. Komponentët kryesor të cilët do të jenë pjesë e strategjisë së online learning mund të jenë si më poshtë:

- Platforma të ndërveprimit online. Disa aplikacione të cilat mund të përdoren për të kryer këto funksione janë Microsoft Teams, Cisco Webex, Zoom.
- Platforma e menaxhimit të trajnimeve online dhe përgatitjes së formave të testimit ose anketimit. Disa aplikacione të cilat mund të përdoren për të kryer këto funksione janë Google classroom, LMS365, Moodle.
- Platforma të ruajtjes dhe shpërndarjes së materialeve të trajnimit. Disa aplikacione të cilat mund të përdoren për të kryer këto funksione janë Microsoft sharepoint, Microsoft Teams, Google calroom, Moodle.
- Software të përpunimit të materialeve audio, video dhe vizual. Disa aplikacione të cilat mund të përdoren për të kryer këto funksione janë Adobe premier pro, Corel videostudio ultimate, Powerful Video Creation.
- Software për përpunimin e dokumenteve dhe materialeve të trajnimit. Disa aplikacione të cilat mund të përdoren për të kryer këto funksione janë Microsoft office, Microsoft office 365.
- Bazë të dhënash dhe platforme të raportimit. Disa platforma bazash të dhënash të cilat mund të kryejnë funksione e regjistrimit të të dhënave janë Microsoft SQL Server, Oracle, Postgres, MySQL.
- Pajisje të regjistrimit të trajnimit. Pajisje të nevojshme për të kryer këto funksionalitete si Kamera digjitale të lëvizshme PTZ, Workstations dhe mikrofonta.
- Serveri i regjistrimit dhe transmetimit të trajnimit online.

Komponentët e mësipërm mund të implementohen edhe të ndarë nga njëri tjetri dhe në faza të ndryshme të projektit.

Kjo mënyrë mund të jetë efikase nëse platforma online learning do të financohet pjesërisht, ose nëse burimet e financimit do të jenë të ndryshme.

Strategjia e ndërtimit dhe vendosjes në punë e platformës online learning duhet të jetë gjithmone e qartë dhe burimet e financimit të të gjithë komponentëve duhet të identifikohen paraprakisht në mënyrë që të ndiqet strategjia e duhur e formulimit dhe dorëzimit të dokumenteve në kohë dhe sipas standardeve të kërkuara nga çdo financues.

6 Kontrolli i sistemeve dhe asetëve.

6.1 Asetet fizike.

Asetet kryesore që duhet të parahikohen janë: një sallë trajnimi, që përdoret gjatë trajnimeve të ndryshme, si edhe pajisjet elektronike ku përfshihen kompjuterët, projektori, tabela dhe kamerat. Gjithashtu edhe tavolinat bashkë me ulëset e përshtatshme, në rastet kur ka ndërthurje mes mësimit fizik dhe atij online.

6.2 Asetet software.

Elementët software që mendohet të përdoren duhet të jenë të përditësuara me të dhënat e fundit të teknologjisë, në mënyrë që mos të krijohen probleme gjatë zhvillimit të mësimit, apo procedurave të tjera online.

6.3 Burimet njerëzore.

Stafi duhet të jetë i mirëtrajnuar në proceset e organizimit të mësimdhënies, si fizike, ashtu edhe online. Proceset e punës duhet të jenë të ndara, ku një pjesë e grupit duhet të fokusohet në procesin e organizimit të trajnimit, si edhe një pjesë në mirëmbajtjen e sistemeve dhe proceseve teknologjike.


6.4 Analiza e nevojave.

Bazuar në volumin e trajnimeve të kryera mund të vihet re nevoja për sisteme profesionale dhe gjithëpërfshirëse në fushën e trajnimeve të cilat mundësojnë lehtësimin e procesit të trajnimit si dhe rritjen e cilësisë së trajnimit. Modernizimi i procesit të trajnimit, që është pjesë e strategjisë së zhvillimit të trajnimeve online sjell nevojën për staf të kualifikuar teknik, i cili do të jetë përgjegjës për të operuar sistemet hardware dhe software të cilët pritet të implementohen. Procesi i trajnimit online do të ketë rrjedhën logjike sipas skemës së mëposhtme:

Krijimi i trajnimit online




Zhvillimi i trajnimit online



Bazuar në rrjedhën e proceseve të përshkruam më sipër dhe analizës së kryer për krijimin e një sistemi gjithëpërfshirës të komponentëve të strategjisë “Online learning” nevojiten këto funksionalitete.

6.5 Komponentët software

Moduli software duhet të ofrojë mundësinë e krijimit të një trajnimit online duke ofruar lehtësi në krijimin e trajnimit së bashku me përshkrimin përkatës duke ofruar mundësi përshkrimi të detajuar të trajnimit online dhe duhet ti japi mundësinë operatorit i cili krijon trajnimin të bashkëngjisë dokumente të ndryshme të cilat japin informacione më të detajuara për trajnimin. Është shumë e rëndësishme që komponentët software të kenë një integrim sa më të madh midis tyre si dhe të lejojnë automatizimin e proceseve të ndryshme gjatë ciklit të jetës së një trajnimit. Më poshtë jepet skema e komponentëve software të cilët mund të përdoren për zhvillimin e plotë të trajnimit duke filluar që nga krijimi i trajnimit e deri në përfundimin e tij.



Pasi të jetë krijuar trajnimi nëpërmjet softit duhet që të mund të dërgohet linku i trajnimit në web duke përdorur lista e-mail-i të pjesëmarrësve të cilët do të jenë pjesë e trajnimit. Duhet parë mundësia nëse njoftimi për trajnim të mund të përdori edhe rrugë të tjera njoftimi përveç emailit ku mund të përmendim aplikacion i personalizuar. Në këtë mënyrë do të mundësohet njoftimi me lehtësi i pjesëmarrësve në trajnim.

Njoftimi me email apo nëpërmjet programit duhet të japi mundësinë e regjistrimit të trajnimit në kalendarët e ndryshëm të përdorur nga pajisjet elektronike kompjutera, telefona celular apo tableta. Në këtë mënyrë pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të njoftohen para fillimit të trajnimit nëpërmjet kalendarit të tyre duke ju lejuar atyre të menaxhojnë më mirë kohën.

Të gjithë pjesëmarrësit në trajnim duhet të kenë mundësinë të kryejnë regjistrimin online për trajnim duke përdorur një formular online i cili duhet të jetë sa më intuitiv dhe i lehtë për tu plotësuar. Formulari nuk duhet të jetë i komplikuar dhe duhet të ndërtohet në mënyrë të tillë që pjesëmarrësi në trajnim të mund ta plotësoj atë brenda një kohe të shkurtër jo më shumë se 60s.

Mund të krijohet mundësia që të mund të shpërndahen materialet e trajnimit në çdo kohë pasi të jetë krijuar trajnimin në komponentin software i përshtatshëm për këtë qëllim. Këto materiale mund të dërgohen para se të kryet trajnimi, gjatë trajnimit apo pasi është kryer trajnimi. Një trajnim mund të ketë më shumë se një material ndihmës dhe kjo tufë materiale mund të dërgohet në faza të ndryshme të ciklit të jetës së trajnimit.

Trajnimet e zhvilluara online mund të japin mundësinë nëpërmjet formave të ndryshme elektronike për të kryer testime të pjesëmarrësve apo anketime të tyre. Format e testimit duhet të japin mundësinë e një hapësire të gjerë formulimi pyetjesh ku mund të përmendim pyetjet me zgjedhje, me alternativa, ese apo pyetje me më shumë se një zgjedhje. Testimi aty ku është e mundur mund të kryejë në mënyrë automatike vlerësimin e testit të kandidatit për çdo pyetje. Në rastin e pyetjeve ese duhet që trajnuesi apo persona të tjerë përgjegjës të kryejnë korrigjime manuale të pyetjes. Çdo test së bashku me detajet përkatës ruhet në një bazë të dhënash e cila më vonë mund të konsultohet ose mund të përdoret për krijimin e raporteve të ndryshme. Formularët e anketimeve duhet të kenë mundësinë e identifikimit të të anketuarit online pjesëmarrës në trajnim ose lënien e tij në anonimitet sipas qëllimit të anketës. Rezultatet e anketave të cilat kryhen pas sesioneve të trajnimit online duhet të ruhen në një bazë të dhënash nga e cila mund të ndërtohen raporte të ndryshme.

Gjatë zhvillimi të trajnimit apo edhe në momente të tjera mund të zgjedhit të kryhen regjistrime audiovizuale të shoqëruara me animacione, prezantime, materiale, dokumente të cilat do të mund të përdoren për t'ju ardhur në ndihmë punonjësve të interesuar për të rritur aftësitë e tyre profesionale duke ndjekur këto materiale offline dhe sa herë të kenë nevojë. Në këtë mënyrë do t'ju ofrohet mundësia të trajnuarve të analizojnë dhe përvetësojnë materialet e trajnimit në një kohë të përshtatshme për ta. Aksesit në këto materiale kontrollohet kryesisht duke përdorur mënyrën standarde të aksesit duke përdorur një emër përdoruesi dhe një fjalëkalimi, që jep mundësinë të aksesojë vetëm materialet sipas nevojës.

7. Implikimet Financiare .

7.1. Mbulimi i buxhetit/ Të ardhurat.

E-Learning është një treg në rritje, megjithatë është kosto e lartë dhe konsumim kohe për të zhvilluar eksperiencat e të mësuarit interaktiv të cilësisë së lartë dhe medias të pasur (dhe të jesh konkures në çmime). Pak njësi virtuale ne eksperiencat e universiteve ne bote kanë siguruar një mbulim të buxhetit dhe shumë prej tyre kanë mbyllur procedurat e mësimit elektronik. Njësitë virtuale që janë më të suksesshme në ofrimin e spektrit të plotë të zgjidhjeve E-Learning, kane zgjedhur të zgjerojnë aksesin në edukimin cilësor për audiencën e synuar dhe jashtë saj, dhe jo vetëm kthimin e investimit te buxhetit.

7.2. Kostot.


Buxheti në momentin e hartimit të strategjisë mund të pasqyrojë çfarë do të nevojitet për të lançuar një njësi të centralizuar për të mbështetur spektrin e plotë të aktiviteteve të E-Learning dhe për të mbuluar përdorimin e teknologjisë së edukimit.

Megjithatë, me përjashtim të nevojave buxhetore, shumë aktivitete kërkojnë angazhimin e njohurive, kohës dhe energjisë së stafit të dedikuar të menaxhimit të të mësuarit dhe të teknologjisë së informacionit.

7.3 Infrastruktura Fizike.

Infrastruktura fizike përbëhet nga të gjitha pajisjet të cilat mund të përdoren gjatë zhvillimit të trajnimit online ku përshihen servera, kamera, mikrofonë, projektorë, pajisje mobile apo kompjuterë personal të cilët mund të përdoren vazhdimisht ose sipas nevojës gjatë zhvillimit të trajnimit.

Aneks I: Shembull i organizimit të sallës së trajnimit online




Aneks II: Mjetet për transmetimin e trajnimeve Online Streaming

Shpesh herë gjatë sesioneve të trajnimit mund të jetë nevojë për transmetimin e trajnimit online në platforma të ndryshme streaming si facebook apo youtube. Për këtë arsye nevojiten program i përshtatshëm i cili do të mundësojë transmetimin e trajnimit online në kohë reale. Në mënyrë që të realizohet ky funksionalitet nevojitet programi i përshtatshëm i cili mund të ketë specifikat si më poshtë:

- Të lejojë integrimin me kamera të llojeve të ndryshme
- Të ketë mundësi regjistrimi video
- Te mundësojë transmetim online në kohë reale të videove në platforma të njohura si facebook, youtube etj.

Skema e transmetimit livestream



Bibliografia

Libra:

- "E-Learning and the Science of Instruction" by Ruth C. Clark and Richard E. Mayer.
- "The Online Teaching Survival Guide" by Judith V. Boettcher and Rita-Marie Conrad.
- "E-Learning by Design" by William Horton.

Revista Akademike:

- "Journal of Online Learning and Teaching" (JOLT)
- "International Review of Research in Open and Distributed Learning" (IRRODL)
- "Educational Technology Research and Development" (ETR&D)

Website:

- <https://elearningindustry.com>
- <https://www.elearningguild.com>